
DOKUMENTE E MATERIALE

**A. ZOGU SIPAS OPINIONIT TË PËRFAQËSUESIT BRITANIK
NË SHQIPËRI, HOXHSON DHE POLITIKA E TIJ NDAJ
SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI SIPAS DISA
DOKUMENTEVE TË MP TË JASHTME TË SHQIPËRISË****Karakteristikat e A. Zogut sipas konsideratave të diplomatit
britanik në Shqipëri, Hoxhson, në vitin 1935**

Për “Mbretin e shqiptarëve”, Ahmet Zogun, nuk është folur e shkruar pak. Por në shumë raste kur është përmendur, mandej edhe në artikuj e monografi që i kushtohen tërësisht atij, zakonisht vlerësohet maksimalisht ose akuzohet e denigrohet rëndë. Edhe në përpjekjet që janë bërë për ta portretizuar me realizëm, rëndom vërehet një pozicion i paracaktuar. Subjektivizmi nuk mungon as në biografinë e shkurtër të A. Zogut, të përgatitur në vitin 1935 nga përfaqësuesi britanik në Shqipëri, Hoxhson (Hodgson), për t’ia relatuar Forin Ofisit. Natyrisht, për një diplomat të karrierës si Hoxhsoni, tiparet e Mbretit të shqiptarëve janë skicuar jo vetëm në bazë të impresionave personale, por edhe duke gjykuar brenda kuadrin të linjave të përcaktuara të politikës britanike për kohën në Shqipëri, në Ballkan e më gjerë. Gjithsesi curriculumi që Hoxhsoni i bën A. Zogut, ka origjinalitet dhe meriton vëmendje. Ai ndihmon për të kompletuar pikëpamjet dhe vlerësimet e ndryshme rreth njërit prej personaliteteve më të spikatur të historisë sonë.

Në kuadrin e krijimit të një ideje sa më të saktë për personalitetin e A.Zogut, opinionin e Hoxhsonit shoqërohet më poshtë edhe me disa dokumente të viteve 30, të cilat dëshmojnë për politikën zyrtare të Shqipërisë dhe natyrisht të mbretit, ndaj shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi në atë periudhë. Nga këto dokumente, duke filluar nga “Dekretligji mbi vendosjen e emigrantëve” i vitit 1931, që përcaktonte kriteret e përkrahjes shtetërore për shqiptarët e ardhur në Shqipëri nga viset etnike të copëtuara më 1913, e deri te “Promemoria” e M.P. Jashtme e 20 marsit 1939, dërguar stafit të vet diplomatik të akredituar në Jugosllavi me orientime për politikën që

duhej ndjekur në mbështetje të popullsisë shqiptare në Jugosllavi, provohet se Tirana zyrtare dhe drejtuesi i vendit A.Zogu, nuk i kishin jashtë vëmendjes shqiptarët e trevave jashtë shtetit shqiptar.

Marenglen VERLI

*

* *

Mbi personalitetet politike shqiptare*

Ahmet Zogu

Zogu I – Mbret i shqiptarëve – Ahmet Bej Zogu, tani mbreti Zog, lindi 40 vjet më parë në Burrel, në krahinën e Matit. I ati, Xhemal Pashë Zogu, kryetar i Matit, u martua dy herë. Me gruan e parë ai pati një djalë, Xhelalin, i cili është martuar, por nuk ka fëmijë. Gruaja e tij e dytë, Sadija, anëtare e familjes së pasur të Toptanëve, e cila vdiq në nëntor 1934, ishte nëna e Ahmet Beut dhe e gjashtë bijave. Adilja, bija e madhe, u martua me Emin Agollin, Barishtin, prej Dibre dhe ka tre djem dhe dy vajza. Dy djemtë e mëdhenj Saliu dhe Hyseni janë në St. Cyr (Akademia Ushtarake Franceze). Bija e dytë. Nafija ishte e shoqja e Cen Bej Kryeziut, që u vra në Pragë në vitin 1927. Ajo ka një djalë Esatin. Të katër motrat e tjera të mbretit Zog, janë të pa martuara, siç është edhe ai vetë. Trashëgimtari i fronit supozohet të jetë njëri nga katër nipat e tij.

Ahmet Beu kreu mësimet në Stamboll, deri në moshën 16-vjeçare, kur u kthye në Shqipëri. Që kur ishte djalë dilnin të qarta cilësitë e tij. Më 1912-ën, ai mblodhi njerëzit e tij dhe u bashkua me Hasan Bej Prishtinën, Riza bej Kryeziun nga Gjakova dhe Bajram Currin, e ishte ngritur kundër Xhonturqve në Kosovë. Disa muaj më vonë, kur shpërtheu Lufta Ballkanike ai luftoi nga ana e Turqisë, por pas një përpjekjeje me malazetët në Lezhë, ai u kthye në Mat. Më 1914-ën i ofron shërbimet e tij Princ Vidit, por shumë shpejt kuptoi paaftësinë e Vidit dhe e braktisi. Një vit më vonë, priti ushtrinë austro-hungareze, duke besuar se pavarësia e Shqipërisë mund të sigurohej me ndihmën e tyre. Austriakët, që nuk kishin asnjë qëllim të mbështesnin pavarësinë e Shqipërisë, menduan se ky i ri energjik do të ishte më pak i rrezikshëm jashtë Shqipërisë dhe e ftuan në Vjenë, ku në fakt u mbajt i izoluar. Pas luftës, ai u kthye në Shqipëri dhe bashkë me Aqif Pashën e Eshref

* *Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), Fondi Public Record Office - Foreign Office – London, L.573. Raporti Vjetor i Legatës Britanike në Durrës “Mbi personalitetet politike shqiptare”, Durrës, 4 shkurt 1935, nga R.H. Hodgson.*

Frashërin organizuan Kongresin e Lushnjes, që u mbledh në janar të 1920-ës, i cili zgjodhi Këshillin e Lartë të Regjencës dhe formoi Qeverinë. Nga ky kongres fillon epopeja e historisë moderne të Shqipërisë. Nuk është nevoja të ndiqet karriera e Ahmet Zogut në detaje në këtë periudhë. Ai ka mbajtur portofole të ndryshme në qeveritë që erdhën njëra pas tjetrës dhe u bë kryeministër në 1922-in. Në 1921-in, smira për influencën që kishte fituar dhe pakënaqësia në popull shkaktuan një kryengritje të armatosur. Ai iku në Jugosllavi. Fan Noli formoi qeverinë e tij jetëshkurtër. Në dhjetor të po atij viti Ahmet beu në krye të një force, që përfshinte edhe një kontingjent rusësh të bardhë të ushtrisë së gjeneralit Vrangel dhe me mbështetjen e qeverisë jugosllave, hyri në Tiranë. Fan Noli dhe përkrahësit e tij ikën dhe Ahmet beu e deklaroi veten diktator dhe kryekomandant dhe thirri një Asamble Kombëtare, e cila më 22 janar 1925 proklamoi Republikën dhe më 31 janar e zgjodhi president. Më 1 shtator 1928, një Asamble Kushtetuese e zgjedhur për të modifikuar kushtetutën i ofroi Ahmet beut, “shpëtimtarit të kombit” kurorën e Shqipërisë, të cilën ai e pranoi, duke marrë titullin “Mbret i shqiptarëve”.

Kështu Ahmet Beu arriti atë që me opinionin e disa vëzhguesve kishte qenë qëllimi i tij që kur 17 vjet më parë ai ishte i zhytur në politikën shqiptare. Nuk mund t’i mohohen disa cilësi të shquara. Forca e tij kryesore pa dyshim qëndron në faktin se ai e dinte me saktësi atë që donte, dhe nuk kursen asnjë mundim për të arritur objektivin e caktuar. Ai posedonte kurajë dhe gjakftohtësi dhe një aftësi të pakufi për intrigë. Ishte i pa penguar nga skrupuj që mund ta ndalnin në rrugën e tij. Ai ka njohuri shumë të thellë për mentalitetin e popullit të vet dhe nxitet nga patriotizmi i sinqertë, megjithëse duhet thënë se kjo trajtë e karakterit të tij i nënshtrohet bindjes se ambicia e tij personale dhe interesat e Shqipërisë janë lidhur së bashkë në mënyrë të pandashme. Thuhet se ai është i pamëshirshëm dhe ka kryer akte të pamëshirshme kur e ka dashur nevoja, por ai nuk është i pamëshirshëm në vetvete dhe zakonisht është zemërgjerë ndaj kundërshtarëve të tij. Për shokët dhe miqtë dhe për ata që i kanë qëndruar pranë në çaste të vështira dhe të nevojës, ai është treguar besnik deri në fund.

Ai shumë rrallë akordon besimin e tij dhe është mjeshtër në fshehjen e mendimeve dhe qëllimeve të tij. Shkëlqen dhe dhënie e përshtypjes se të tjerë dhe jo ai po ndjekin objektivat që ai ka vënë në shënjestër dhe se ai vetëm i përshtatet dëshirave të tyre. Që kur është bërë mbret, të metat i kanë dalë në shesh më tepër se cilësitë. Qeveria parlamentare demokratike e Shqipërisë është diktaturë e maskuar dhe Ahmet Beu po tregohet një diktator mediokër. Pamundësia e tij për të besuar të tjerët dhe xhelozia për pushtet, që nuk e

lejojnë t'u akordojë autoritet të tjerëve, hedhin mbi shpatullat e tij të gjithë peshën e administratës. Ai përpiqet ta përballojë këtë barrë dhe e gjen tepër të rëndë për vete, duke mos i pasur aftësitë konstruktive dhe dituritë e nevojshme. Zgjuarsia e tij tani është bërë më tepër pengesë se sa ndihmë, kurse besnikëria për shokët dhe miqtë është shkaku për një rënie të popullaritetit, sepse me personin e tij janë bashkuar një grup parazitësh egoistë pa vlerë. Ata mund të kenë qenë të dobishëm në të kaluarën dhe atij i vjen keq t'i hedhë poshtë. Mirëpo, nëpërmjet tyre ai njihet nga populli i vet dhe nga veprimet tyre gjykohej. Po të ishte se do të përpiqej të krijonte një kontakt të ngushtë me popullin, që dikur ishte forca e tij, ai prapë do të mund të fitonte popullaritetin e mëparshëm. Fatkeqësisht tendenca është në drejtim të kundërt. Ai jeton i mbyllur në pallat në Tiranë, ose në vilën e tij në bregdet dhe populli nuk e sheh kurrë. Duket se ka humbur cilësinë për të marrë vendime të shpejta dhe kënaqet t'i lërë që punët të shkojnë si të shkojnë. Nganjëherë arrin të kuptojë nevojat e vendit dhe shfaq qëllimin që të zhdukë abuzimet dhe të kufizojë aparatin shtetëror, tepër të zgjeruar dhe të panevojshëm, por tani i mungon energjia për të vënë idetë në praktikë dhe bën pak për të ndrequr të metat në administratën e vendit.

Puna e jashtme gjithmonë ka qenë fusha e tij e preferuar dhe, duke pasur parasysh se Shqipëria ndodhet ndërmjet dy fqinjëve të fuqishëm, që e urrejnë njëri-tjetrin, mundohet t'i përdorë për qëllimet e tij. Por nuk mund të thuhet se ai është sjellë me ta në mënyrë të mençur. Një njeri më i zgjuar do të kishte par për avantazhin e vet, duke marrë ato ndihma që do të mund të merrte prej tyre, pa u lidhur me asnjërin.

Politika e Mbretit Zog ka qenë të lidhë veten alternativisht me njërin apo tjetrin. Si rezultat ka fituar mosbesimin e thellë të të dy palëve.

Në trajtimin e çështjes minoritare, ai gjithashtu ka treguar një mungesë praktikiteti. Shqipëria është një vend i vogël, me një numër të madh shqiptarësh jashtë kufijve, prandaj është në interesin e saj, siç ka thënë vetë mbreti, që të trajtohen minoritarët brenda kufijve me sjellje shembullore. Nuk ka bërë kështu. I nxitur nga ide nacionaliste të tepruara, ai i vuri detyrë vetes të shqiptarizojë minoritetet raciale dhe fetare. Kështu, pa asnjë nevojë, i ka futur veten në telashe me Greqinë, duke mos përfillur detyrimet e tij dhe duke mbyllur shkollat e minoritarëve grekë dhe, ndaj Italisë, duke mbyllur shkollat katolike. Të mos përmendim pastaj Jugosllavinë, minoriteti i vetëm i të cilës ishte fshati Vrake afër Shkodrës, që u ngrit i tëri dhe emigroi në masë në Jugosllavi, pas ndërhyrjes ndaj shkollës dhe kishës së tyre.

*

*

*

DOKUMENTE PËR QËNDRIMIN E SHQIPËRISË ZYRTARE NDAJ SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI

Dekretligji i Shqipërisë i vitit 1931, i miratuar nga A. Zogu mbi vendosjen e emigrantëve në Mbretërinë Shqiptare

DEKRETLIGJI MBI VENDOSJEN E EMIGRANTËVE

Art.1

Gjith ata persona të lemun jashta kufive të Shqipnis independente, që janë Shqiptare prej gjaku dhe gjuhe, pa ndryshim feje dhe seksi, të cilët, tue u shpërngul nga vendet e origjinës tyne, vijnë në Shqipniën e lirë me qëllim vendosje dhe mos këthyerjeje përsëri në vendet e tyne, kanë të drejtë m'u i si emigrand në Shqipni, në konformistet me dispozitat e kësaj Ligje.

Art.2

Emigrantët e treguem në nenin e ma sipërm, përsa asht e mundëshme, do t'i drejtohen organeve konsulluer e diplomatik të Shtetit Shqiptarë ose ç'do autoriteti tjetër Shqiptar ma të parë kompetent tue ju paraqitë një lutje, ku do të tregohet qëllimi i shpërnguljes prej vendit t'origjinës, me mendim mos kthimi përsëri dhe me u vendos në Shqipnië.

Lutjes në fjalë do t'i shoqnohet një listë e cila do të përmbajë gjithë gjendjen civile t'emigrantit dhe t'antarëve të familjes që kryeson tue i shtue edhe për ç'do përsôn një fotografie të vogël.

Art.3

Autoritetet e treguem n'artikullin e sipërmë, kuer marrin një kërkesë të tillë dhe konstatojnë se kërkuesi i përmbahet të gjitha dispozitave t'Art.1 të kësaj Ligje, lajmojnë me një herë Ministrinë prej së cilës mëvaren e kjo i-a njofton Drejtoris së Përgjithshme të Reformës Agrare.

Autoritetet e kufinit personat e emigruem kanë me i nisë drejt për së drejti në Kryeqytet ose ndër vende që u janë shenjue ma parë prej Drejtorisë kompetente.

Art.4

Në rasë që emigrantat nuk kanë mjete ushqimi deri sa të mrrijnë në vendin e destinuem për instalim, autoritetet administrative, të cillave u janë drejtue emigrantat, kuer kanë kredi relative në dispozicion, si mbas nevojës qi të faqet, detyrohen me u pague shpenzimet e udhëtimit si mbas rasës me kal ose me automobil, dhe për ushqim e fjetje t'u jepen Fr. ari 1 deri 2 për çdo personë.

Këto shpenzime do të llogariten në bregdetin e Drejtoris së Përgjithshme të Reformës Agrare.

Art.5

Në rast që Emigrantët, për arsye të pranueshme, nuk kanë krye këto formalitete as pranë autoriteteve konsulluer e diplomatikë Shqiptar, as pranë autoriteteve kufizuer, do t'i drejtohen autoritetit administrativ të vendit të destinimit, të cilët obligohen me përpillue listat e gjendjes civile, e me u qitë fotografitë, si mbas dokumentaret që mund të kenë, dhe, kuer këjo nuk asht e mundëshme, si mbas informatavet të marruna dhe të shpjegimeve të dhanuna verbalist prej t'intereruemve.

Art.6

Zyrat e emigrantave ose nëpunësat që përfaqësojnë këto Zyra në Prefektura ose Nënprefektura, që nga data e hymjes t'emigrantave në Shqipni, detyrohen me u dhanë për çdo frymë fr. ari 0.40 në ditë. Kjo ndihmë vazhdon një vit, tue u paguar në katër kiste të njishme.

Art.7

Organet e Zyrës s'Emigrantave janë të detyruar të kërkojnë dhe t'u gjejnë punë emigrantave e të vazhdojnë mirë-rrojtjen e tyne.

Art.8

Mjeksit e Bashkies, të Komuneve dhë të Shtetit, detyrohen me i mjekue emigrantat e vobekët gratis dhe Zyra e Shëndetësies obligohet me ju dhanë barna pa shpërblim.

Art.9

Teshat, moblijet, shtresat, enët, veglat, mjetet bujqësore ose industriale, shpendët, shtazët të trasha dhe bagtie që sjellin emigrantët me vehte përjashtohen nga tagri doganuer t'importimit si mbas periudhës parë të paragraf. VII, t'Art.4, dhe të periudhës parë të Art.5 të Ligjës së tarifës; gjithashtu të gjitha këto sende përjashtohen dhe nga të gjitha taksat e tjera municipale, komunale ose arsimore.

Art.10

Gjith personat emigrues detyrohen me u rregjistruer në Zyrën e Gjendjes Civile ku do t'instalohen si shtetas Shqiptarë; letër-njoftimet u lëshohen gratis.

Art.11

Që nga dita e rregjistrimit, për 5 vjet, përjashtohen nga shërbimi ushtarak dhe tre vjet nga detyrimi i punimit në rruga kombtare dhe Komunale; në kohë lufte ky përjashtim s'ka efekt.

Art.12

Shteti, nga pasunija e vet, u ep gratis emigrantave për truall të shtëpiës, (qi do të goditet si mbas planit të pregaditun nga Drejt. e Reformës Agrare) për dipendencat e për kopshtin 2500 m² tokë; posë kësaj, për çdo frymë të familjes, u epet dhe nga ½ hk. (gjysmë hektari) tokë të panuëme ose livadhe, tue mos cenue nevojat e bujqve t'instaluemun n'atë vendë.

Art.13

Shtëpia dhe tokat e tregueme në nenin e masipërmë, që nga dita e instalimit për pesë vjet rrjeshtas, janë të përjashtuese nga e dheta, nga kontributa e ndërtesave dhe nga çdo llojë takse të pasunivet të palujshme.

Kafshët e holla dhe të trasha t'emigrantave përjashtohen nga taksa përkatëse për tre vjetë t'instalimit.

Art.14

Tokë të punueshme u falen emigrantave, që janë bujq dhe kanë pasë për profesion të përhershëm bujqësin e blegtoriën.

Përsonave tjerë, që janë marrë me tregëtië të ndryeshme, u falet nga një copë truall sa për me ngreh shpi brenda në qytet, n'ato vende ku ka pasuni Shteti. Kjo kategori nuk përfiton nga ndihma që u përmendë në nenin e sipërmë.

Art.15

Emigrantët, që janë marrë me zeje detare, si barkar, peshkatar ose marinat, instalohen në brigjet e detit të Shqipnies; veglat dhe mjetet e peshkimit, të barkimit due t'anijetimit, kuer këto i sjellin me vehte të përdoruna, përjashtohen nga tagri doganuer i importimit.

Art.16

Emigrantët, që janë mësue me punue mëndafshin ose duhanë, instalohen nëpër vende ku, nga pikëpamja e teknikës bujqësore, mund t'i zhvillojnë këto lloje bujqësore, dhe ata, që janë marrë ma tepër me ushqimin e kafshëve se sa me livrimin e tokave, instalohen në për vende ma të volitshme për jetën e tyre.

Art.17

Tokat, që u akordohen emigrantavet, janë këto që vijojejnë:
a) tokat e punueshme e livadhet që formojnë pasunin e Shtetit;
b) tokat që formojnë pasunin patrimonjale rurale të Bashkive ose të katundarive;
c) tokat e çpronësue me prej Zyrës Agrare në konformistet me ligjën relative, mbassi të jenë vendosur tanësisht bujqit proletar.

Art.18

Landa e ndërtimit të shpis dhe të dipendencave të sajë u falen gratis nga pyjet Shtetnore e, në mungesë të këtyre, nga pyjet municipale ose komunale, ose nga pyjet e çpronësue në konformitet me ligjën e Reformës Agrare.

Gjith ashtu, përjashtohen nga të gjitha taksat përkatëse guroret, furrat gëlqerje, kumit e tullave e të qerpiçëve. Në këtë përjashtim hynë dhe lëndët që përdoren për fabrikimin e veglave bujqësore instrumentave zejtarile, industrorre dhe detare, (fluga, barka e anija) të bamuna prej emigrantavet e që përdoren prej tyre.

Art.19

Emigrantat, që vendosen në një katund, çiflig ose qytet, përfitojnë nga të drejtat e kullotjes dhe e korrjeve vetëm ndër prona Shtetnore e private të çpronësuese, dhe tokët e tyre gëzojnë të drejtat e të gjitha serviturevet që kanë pasë ma parë.

Art.20

Në rast se emigrantat formojnë katunde të veçanta, ju akordohet toka gratis për xhami, për Kishë, Shkolla, varreza e godina pleqësore për një dyqan, kovaçhanë, samarxhihane, një shesh për mbledhje të përgjithme dhe një për fot-boll ose për tjetër sport, një sasi vendi t'arsyeshëm për lulishtë të katundit, për lamë dhe vend për një depo të veglave dhe të materjalevet bujqësore të kooperativës, që ka me formue katundi, si edhe për çeljen e rrugëve të katundit.

Art.21

Kuer e lypë nevoja e instalimit dhe e shëndetësiës s'emigrantave, me hirin e të dy palëve mund të blehen tokë, livadhe ose kullosa që ndodhen nën zotnim legjitim të privatëve e qi nuk çpronësohen.

Të blemit e tokave për nevojë të nalt-përmenduna bahet me fondet e posaçme të Zyrës s'emigrantavet.

Art.22

Emigrantat, që nuk janë Shqiptarë nga gjaku e nga gjuha, nuk përfitojnë nga të drejtat e akorduese prej kësajë Ligje.

Art.23

§ I. Emigrantavet bujq, përveç ushqimit të përmendun në nenin e posaçëm, do t'u epen farë, do t'ju plotësohen kafshët deri me një pendë që dhe një lopë me qumësht ose pesë dhen pleja, dhe veglat bujqësore. Gjith-ashtu, do t'ju ngrehet ose do t'ju ndihmohet për ngrehjen e shtëpiës, në formën ma ekonomike, fund e krye si mbas preventivit të Drejtoris së Përgjithshme të Reformës Agrare.

§ II. Emigrantat janë të ndaluem me jetërsue shpijat e tokat e akorduese prej Mbretnis Shqiptare brenda 15 vjetëve ç'prej ditës së dorëzimit të tyre.

§ III. Shpenzimet e instalimit si edhe t'ushqimit paguhen nga fondi i caktuam në budgetin për instalimin e emigrantave.

§ IV. Drejtorija e Përgjithshme e Reformës Agrare, me anën e Zyrave t'emigrantave, do të mbajë një llogari të veçantë për ç'do familje të instaluese, tuej shenjue gjitha shpenzimet e bamuna për të si mbas Ligjës kontabilitetit të Rregullores të posaçme; për këtë shkak të gjithë antarve të familjeve u epet nga një letër njoftim me fotografën e tyre, ku si mbas raset do të shenjohen ndihmat e dhanuna. Kjo llogari, mbassi të vërtetohet edhe prej Kryetarit të familjes, do të mbahet në dy kopje, prej të cilave njena do t'i dërgohet Financës ose bankës Agrare d.m.th. Zyrës së ngarkueme me mbajtjen e llogarive të shpenzimeve të përgjithshme.

§ V. Shpenzimet e bamuna për instalimin e emigrantave si mbas artikujve të sipërme kanë me u rimborsue prej emigrantit detyrues brenda 15 vjetëve e me kiste të njëjshme, tue fillue 5 vjetë mbas ditës s'instalimit; këto shpenzime do t'i kthehen Arkës së Shtetit ose Bankës Agrare, qi ka avancue fondin.

Për këtë qëllim, emigranti detyrues ka për të dhanë një dëftesë detyrimi të posaçme, e cilla me anën e Zyrës Agrare ka me i u dorëzue Arkës së Shtetit ose Bankës Agrare.

§ VI. Të blemit e të gjitha gjanave për instalim emigrantash do t'u shtrohet dispozitave të Ligjës së Kontabilitetit e Rregullores relative.

Art.24

Ligja mbi vendosjen e emigrantave më datë 14.VI.1923, bashkë me rregulloren përkatëse, abrogohen.

Art.25

Ligja hyn në fuqi 15 ditë mbas shpalljes në Fletoren Zyrtare.

Art.26

Me ekzekutimin e kësaj Ligje ngarkohet Këshilli Ministrues.

Kryeministri:

Pandeli Evangjeli d. v.

Ministri i Drejtësiës

M. Tutulani d. v.

Ministri i Punve të Jashtme

H. Vrioni d.v.

Ministri i P. të Mbrendëshme

Musa Juka d.v.

Ministri i Arësimit

H. Mosi d.v.

Ministri i Financave

L. Kareco d.v.

Ministri i Punve Botore
Izet Dibra d.v.

Ministri i Ekonomis Kombëtare
Said Toptani d.v.

ZOGU I

Mbreti i Shqiptarvet

Mbi propozimin e Kryeministris Nr. 188-VI, datë 24.VII.1931,
si ndigjoi dhe pëlqeu vendimin e Këshillit Ministruër me datë
20.VIII.1931

DEKRETON

aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës mbi vendosjen e Emigrantavet.
Durrës, më 2 Shtatuer 1931.

ZOG d.v.

ZOGU I

Mbreti i Shqiptarvet

DEKRETON

aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjës më datë 2 Shtatuer 1931,
mbi vendosjen e emigrantave, votuem prej Parlamentit si mbas shkresës
Nr.218-I, datë 12.IV.1932, të kryesis së tij, dhe urdhnnon shtimin e saj në
Kodet e Mbretnis si Ligjë.
Tiranë, më 19 Prill 1932.

ZOG d.v.

AQSh, Fondi: Ministria e Punëve të Brendshme, viti 1932, dos.538,
dok.202-205.

* * *

**Shkresë drejtuar Komandës së Trupit të RM Kufirit
dt.21.9.1936, me të cilën zv./komandanti i Batalionit të Parë
informon për gjendjen e shqiptarëve në Mbretërinë Jugosllave dhe
nxitjen e shpërnguljes së tyre**

MBRETËNIJA SHQIPTARE

Komanda e Baonit I R.M.Kufinit

Nr.240 Res.

21.9.1936

Peshkopi, më

Komandës Trupit R.M.Kufinit

Tiranë

Ju parashtrojmë se Shqiptarët e Shehrit të Dibrës Madhe qi kan nënshtetsin Sllave, na njoftojnë se autoritetet e atjeshme u dhënkkan shum pengime dhe si mbas hetimeve qi kemi zhvilluar asht e vërtetë dhe çashtja qëndron kështu:

Partija qeveritare e Parlamentit paska proponuarë qi gjithë myslimanët t'i shpërngulë nga Jugosllavija, ku ky proponim paska gjetun përkrahjen dhe nga qeveria. Mas vizitës të fundit qi ka bërë Ruzhdi Arasi¹ Beligradit, në mënyrën ma sekrete qenkan urdhëruar gjithë dikasteret e atij Shteti qi popullsis myslimane t'i japin pengime në mënyra të ndryshme me qëllim qi këta të mërzhiten dhe të kërkojnë vetë shpërnguljen. Kjo na faktohet se Nënprefekti i Dibrës nji ditë i ka thënë nji farë Sul Erebarës tregtar në Sheher qi asht mirë të ikish nga Jugosllavija, mbasi të kam mik e të tregoj, po ky Nënprefekt në mënyrë sekrete e private, këtë gja ja ka propozuar dhe Kryetarit të Bashkis Shehrit, po të tillën gja ja ka thënë dhe nji Deputet në Beligrad nji tregtari mysliman nga Shehri dhe për më tepër ky Deputet asht zgjedhur dhe me këto fjalë se unë me shokët e mij kemi dashur qi gjithë-herët t'u përkrahim pse popullsia myslimane e Jugosllavis së jugut mbrin rreth 800 000 frymë, në të cillët 100 000 janë turq e të tjerët shqiptar dhe marrja e masave shtrënguese kundra jush asht në damin e Jugosllavis me qi shpërngulja dhe vendosja e 700 000 frymë shqiptarve në Shtetin Shqiptar jep të forcohet armiku jonë dhe me 700 000 të tjera, e prandaj unë e kam lëftuar këtë ide dhe gjithë-herët kam dashur si unë ashtu edhe shokët e mij t'u japin juve çdo lehtësi me qëllim qi t'afroheni shpirtnisht në Jugosllavi; mirëpo mbas vizitës së fundit qi ka bërë Ruzhdi Arasi

¹ Ruzhdi Aras, ministri i Jashtëm i Republikës Turke.

në Beligrad dhe mbas mbledhjes qi kan bërë pjestarët e Antatës vogël ideja ime dhe të shokve të mi dështoj dhe asht vendosë e urdhnue gjith dikasteret e Shtetit qi juve myslimanët të jugut t'u epet çdo pengim, natyrisht në forma të pa kuptueshme me qëllim qi të kërkoni dhe herë mbas here të shpërnguli nga Jugosllavija, prandaj si mik qi të kam të këshilloj të largohesh nga Jugosllavija.

Shtojmë se personat qi na kan dhënë këto lajme, me sa mund të kuptojmë janë njerës me kulturë të mirë e karakter të naltë, prandaj na ban t'i besojmë. Veç kësaj për sa shohim se popullsinë ne radhë me të vërtetë ju jepen shumë shtërngaca tue gjetun nga një shkak të vogël.

Zav. Komandant'i Baonit I R.M.Kufinit
Kapiten: (Neshet Kolonja) d.v.

Enjinjishme me kopjen e origjinalit
Toger: (Seid Basha)

AQSh, Fondi: MPJ, viti 1936, dos.165, dok.211/1.

* * *

**Njoftim i Legatës Britanike në Durrës për Londrën i 28 nëntorit
1936, ku flitet për një plan jugosllav për të dalë me linjë
hekurudhore, në bregdetin e Shqipërisë dhe për një propozim që
Shqipëria të pranonte 50-60 mijë emigrantë kosovarë**

28 nëntor 1936

Sipas njoftimit me 15 nëntor 1936 M. Stojadinoviç në një fjalim të mbajtur në Shkup, aludoi për nevojën e lidhjes së sistemit hekurudhor të Jugosllavisë me Adriatikut, me një lidhje që do të përshkonte Shqipërinë. A. Zogu i kishte dhënë rëndësi gjuhës së përdorur nga Stojadinoviçi lidhur me trajtimin me të drejtë të banorëve të Kosovës, duke iu referuar (ai, Zogu – red.) abuzimeve të kohëve të mëparshme në lidhje me zbatimin e ligjit agrar dhe të ankesave të tjera. Zogu e çmoi popullsinë e Kosovës 800 mijë frymë. Përfaqësuesi anglez përmendi propozimin e qeverisë jugosllave që Shqipëria të pranonte 50-60 mijë emigrantë kosovarë. Zogu tha se këtij propozimi ende nuk i ishte dhënë, asnjë përgjigje. Përfaqësuesi britanik tërheq vëmendjen se ai në gazetën “Jehona e Beogradit” të dt. 18 nëntor, në fjalimin e Stojadinoviçit, nuk ka gjetur ndonjë gjuhë të veçantë për trajtimin në të ardhmen të kosovarëve me

aq preizione sa i atribuonte Zogu. Ose atij i kanë bërë një redaktim të kujdesshëm dhe ndoshta s'mund të jetë i plotë, nënvizon diplomati, ose Zogu ka patur ndër mend fjalë të shprehura në një rast tjetër.

AIH, Public Record Office, F.O. 371/19478, (Foto 779, nr. 124 (1034/198), f. 301.

* * *

**Vendim nr.216 i Këshillit të Shtetit, dt. 25.06.1937
mbi një ndryshim në Ligjin e instalimit të emigrantëve
në Shqipëri të vitit 1931**

V E N D I M Nr.126

Këshilli i Shtetit në mbledhjen e përgjithshme të mbajtur sot më 25 Qershter 1937, ditën e Premte para dreke, nën kryesinë e Z. Dr. Mirash Ivanajt dhe në ndodhje t'antareve Z.Z. Kristo Floqi, Dr. Demir Villa, Rasim Kalakulla, Teki Selenica dhe Benedikt Blinishti, muer në bisedim shkresën e Ministris së P. të Mbrendshme Nr.22 datë 19 Qershter 1937, me të cilën kërkohet mendimi mbi një çashtje emigrantësh.

OBJEKTI I KONSULTIMIT

A mund të përfitojnë prej ndihmës së transportit dhe ushqim-fjetje që prej kufinit deri në vendin e qëndrimit, si mbas nenit 4 të Ligjes mbi vendosjen e emigrantve, emigrant që nuk e kanë bujqësinë si profesion ndonëse në përfaqësit t'ona kanë deklarue se janë bujq?

ARËSYET E MENDIM

Në nenin 6 të Ligjës mbi vendosjen e emigrantve të vjetit 1931, tue u parapa ndihma e përditëshme emigrantit për një kohë të caktueme, asht përdorë terma e përgjithëshme, emigrant, pa e kufizue në kuptimin emigrant bujk. Por ky nen ka pasë me shtojcë-ligjën mbi ndryshimin e nenit 3 të shtojcë-ligjës mbi vendosjen e emigrantve më datë 7 Maj 1937, një modifikim, qi nuk lën asnjë dyshim mbi domethanien e vërtetë, tue ekskludue prej ndihmës së këtij neni çdo emigrant, qi nuk asht bujk.

Me nenin 14 prap të ligjës mbi vendosjen e emigrantve shprehimisht thuhet se emigrantit jo bujq i jepet një copë truall për ngrehjen e shtëpis nëpër qytet, kur ka tokë Shteti, pa kurrnji ndihme tjetër.

Ligjvuesi, qi ka hartue në një mënyrë kaq të kuartë nenet e nalt-përmenduna, tue përjashtue emigrantët jo bujq nga çdo ndihmë e lehtësim instalimi dhe nga ndihma e përditëshme të kohës së parë, nuk ka mujtë me pasë për qëllim qi po këta emigrantë jo bujq të përfitojnë nga ndihma e nenit 4, qi tue qenë një ndihmë tepër e përkohshme dhe e kufixueme vetëm në ditët e udhëtimit nga kufini deri në një vend të Mbretnis - nuk mund të konsiderohet ndihmë, për arsye se kjo, me të mrritjen e emigrantit në vendin e banimit, automatikisht pritet në bazë të neneve të përmenduna sipër. Po t'i jepet këtij neni një kuptim tjetër, vetiu del pyetja: emigranti jo bujq, të cilit, për arsye se nuk ka vetë as ma të voglën mundësi financiare, Shteti i jep shpenzimet e udhëtimit prej kufinit e deri në vendin e banimit, si do të jetojë në këtë vend mbas ditës së mrritjes?

Përveç sa u tha më nalt, vetë neni 4 me fjalët: “në vendin e destinuam për instalim” tërthorazi lën të kuptohet se ka dashtë të parashifet ndihma e udhëtimit vetëm për emigrantët bujq, mbasi fjala: “instalim” si në këtë ligjë ashtu në çdo veprim rreth emigrantve përdoret në kuptimin “vendosja e përgjithëshme e njëj emigranti në tokën e falun me qëllim punimi bujqësuer”.

E vërteta asht se ligjëruesi e ka ekskludue çdo mundësi qi emigranti jo bujq të jetë pa një shumë të hollash personale ose pa një mënyrë tjetër jetese për kohën e parë të qëndrimit të tij në Mbretnin, deri sa të fillojë ushtrimin e tregtis ose të zëjes.

Gjithashtu nuk mund të përfitojnë nga ndihma e nenit 4 as ata emigrantë jo bujq, qi, me qëllim përftimi ilegal nga ky nen, kanë deklarrue në përfaqësitë t'ona të jashtme cilësin e vet si bujq, tue vërtetue në këtë mënyrë të padyshimtë se e njofin fort mirë ligjën mbi vendosjen e emigrantve dhe qëllimin qi kjo ndjek.

Mbledhja e përgjithëshme tue marrë parasyshë mendimin e shfaqun prej Seksionit të Drejtësis me Nr..., datë 24.VI.1937, ashtu dhe arsyetimin e sipërm, me shumicë votash shfaq mendimin se prej ndihmës së nenit 4 të ligjës mbi vendosjen e emigrantve mund të përfitojnë vetëm emigrantët me profesion bujq dhe vetëm kur ata vetë nuk disponojnë mjete të veta personale, tue ekskludue çdo tjetër emigrant jo bujq edhe në rasë se

deklaron se ka kët cilsi, pa e pasë në realitet, dhe se nuk ka mundësin financiare ta kryejë udhëtimin prej kufinit deri në vendin e qëndrimit.

Antar Dr. Demir Villa d.v.	Antar Kristo Floqi d.v.	Kryetari Dr. Mirash Ivanaj d.v.
-------------------------------	----------------------------	------------------------------------

Antar Benedikt Blinishti d.v.	Antar Teki Selenica d.v.	Antar
----------------------------------	-----------------------------	-------

MENDIMI I Z. RASIM KALAKULLËS

Simbas kuptimit që del prej përmbajtjes së përgjithëshme e sidomos prej dispozitës së nenit 1 të dekret-ligjës mbi vendosjen e emigrantëve, çdo shqiptar qi shpërngulet nga vend'i tij dhe vjen në Shqipni me qëllim të premë të vendoset këtu, ligjërisht ka cilësinë e emigrantit. Prandaj neni 4 i ligjës së nalt-përmendun, me një mënyrë absolute disponon se gjith emigrantave që nuk kanë fuqi financiare, t'u paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe të ushqimit, deri në vend instalimin e tyre, kur prefekturat përkatëse disponojnë kredin e nevojshme. Vendi i instalimit i emigrantëve bujq asht aty ku ndodhet toka që do të punojnë dhe i jo bujqëve, aty ku u akordohet një truall për me ndërtue shtëpin e vet.

Kjo shprehje ligjore, jam i mendimit se, nuk mund të mos merret parasysh, tue u mbështet në observacione e interpretime të tjera. Emigrantët, me cilësinë e tyre si emigrant, nuk mund të kenë lirinë e fakultetin të lëvizin si të duan e të venë ku të duen ata. Emigrantat kur nuk do të shkojnë në vendin e ku i ka shënuem Qeveria, atëherë nuk kanë të drejtë të kërkojnë t'u paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe të ushqimit.

Antar:
Rasim Kalakulla d.v.

Vërtetohet se asht nji me kopjen e origjinalit
Sekretar'i II-të i Emigracionit

AQSh, Fondi: MPJ, viti 1937, dos.155, dok.48-50.

* * *

**Pikëpamjet e qarqeve zyrtare të Shqipërisë të vitit 1937
për çështjen e mbrojtjes së shqiptarëve në Jugosllavi**

Tiranë, 11 janar 1937

Probleme të mbrojtjes së çështjes kosovare u diskutuan nga Komisioni që u mbledh më 6, 7 dhe 11 janar 1937 nën kryesinë e zotit ministër të Punëve të Jashtme (E. Libohova) me anëtarë, z. Rauf Fico, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë deri tash me funksione në Beograd, z. Ekrem Vlora, Sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe z. Hamdi Karazi zv/drejtor për Punët e Lidhjes së Kombeve.

Komisioni, pasi konstatoi politikën shkombëtarizuese jugosllave në Kosovë dhe shpërnguljen e tyre në Turqi, gjykoi të arsyeshme të hartojë programin e punës që vijon:

“I – Të vazhdohet zhvillimi i organizimit për mbrojtjen e elementit shqiptar në Jugosllavi, tue kundërshtue emigrimin e tij kudo qoftë. Për këtë duhet:

- a) Të organizohen elementët nacionalistë shqiptarë të Kosovës;
- b) Të organizohet rinia intelektuale kosovare tue pasur organin e saj në tokën jugosllave nën formën e një fletoreje ose reviste kulturore letrare;
- c) Të botohet një organ politik kosovar në qendrën e Lidhjes së Kombeve që të përkrahë këtë fushatë për organizimin, mbrojtjen dhe kundërshtimin e emigrimit tue dhënë një kujtim të vërtetë në botë të gjendjes së kosovarëve.
- ç) Të kërkohet eventualisht, me ndërmjetësinë e kroatëve, një bashkëpunim me elementët disidentë bullgaro-maqedonas të Jugosllavisë”.

Duke menduar mungesën e mjeteve të qeverisë për të vepruar në këtë mënyrë Komisioni “mori parasysh pikën që vijon:

II-a) Të nisët aksioni diplomatik ndaj Aleates (Italisë – red.) ... që të na informojë nëse vërtetë ekziston marrëveshja turko-jugosllave për shpërnguljen në Turqi të kosovarëve.

b) Në rast se kjo marrëveshje vërtetohet se ekziston, duhet pyetur qeveria italiane me ç’mënyrë mundet të na ndihmojë qoftë ndaj qeverisë jugosllave, me rastin e marrëveshjeve italo-jugosllave që thuhet se duhet të përfundojë tash, qoftë me anën e Lidhjes së Kombeve, qoftë me tjetër mjet.

c) Po në atë kohë kur qeveria italiane të ketë dhënë përgjigje, me mjetet tona diplomatike pranë Lidhjes së Kombeve, ... në Beograd dhe pranë Legatës Jugosllave në Tiranë, duhet të ngrehim zërin për të siguruar veprimin e njëkohshëm shqiptar në atë të Aleates mbi këtë çështjen e ndalimit të shpërnguljes së kosovarëve në Turqi”.

III – Nëse plani i mësipërm dështon “të vijmë në bisedime me qeverinë e Belgradit mbi konditat e krijimit të një zone në tokën jugosllave, gjatë kufirit tonë, për t’iu dhënë kësaj zone të drejta minoritare analoge me ata që qeveria jugosllave i ka njohur minoritetit gjerman të Banatit jugosllav, tue pranue njëkohësisht zbrazjen e elementit shqiptar nga tokat që janë jashtë kësaj zone, për ta instaluar në këtë zonë ose në Shqipëri. Zona në fjalë duhet pranuar si minimum të koncesionit që mund të bëjmë në këtë pikëpamje”. Kufiri verilindor, të jetë pak a shumë vija ujëndarëse e rrjedhjeve në Drinin e Bardhë, Drinin e Zi, në Liqenin e Ohrit, e përgjithësisht ujërave të Adriatikut. Përfshihen Peja, Gjakova, Prizreni, Dibra, Ohri dhe Fushë Kosova. Mbeten jashtë malësia e Rugovës, lumi Ibar, Kallkandeleni, Resnja. “Jugosllavët kanë interes të veçantë ta qërojnë nga elementet alogjene tokën të banuar nga shqiptarët, e cila futet si pykë ndërmjet serbëve dhe maqedonasve dhe tue qenë se kanë interes t’i bashkojnë këto dy elemente me një vazhdim race sllave munden të pranojnë, për të mos krijuar ndalime të bujshme në programin e tyre të sllavizmit, këtë propozim shqiptar që është të paktën pranimi nga ana e jonë e gjysmës së dëshirave të tyre”.

IV – “Në rast se edhe krijimi i kësaj zone nuk do të jetë i mundshëm, atëherë do të duhet, mjerisht të vijmë në marrëveshje me qeverinë jugosllave për të tërhequr atë sasi familjesh emigrantësh kosovarë që do të mundemi të marrim, me nga një shpërblim që do të japë qeveria jugosllave”.

Shënim: a) Në rastet e pikave III, IV të bisedohet dhe çështja e pasurive shqiptare në Jugosllavi që kapin vlerën 400 000 000 dinarë, si dhe pagesa e shpenzimeve për shpërnguljen dhe instalimin e kosovarëve në Shqipëri ngado që të vijnë.

b) Në Organizatën Nacionaliste të Kosovës hyjnë personalitete si Ferhat Draga, Hasan Shyqri etj.

Kësaj organizate t’i jepen 300 napolona në vit. Edhe Vejsel Kryeziut ti jepet një shpërblim mujor. Dhurata periodike tu jepen edhe hoxhallarëve kosovarë. Për ta Legata të disponojë 150 fr.ar. në muaj.

c) Në rininë intelektuale kosovare duhen përkrahur me bursa nga 60 fr. ar secili 13 veta, që deri dje mbaheshin me bursë të Komitetit Mysliman Jugosllav. Ky duke qenë në dorë të boshnjakëve s'mund të tolerojë që intelektualët shqiptarë të dalin nga shkollat e nalta të plotësuar dhe me diplomë.

- Selahudin Ferhat Dragës ti jepet bursë 140 fr.ari në muaj, si e kish dhe motin e shkuar.

ç) Momçillo Ivaniçit, federalist dhe të tjerëve etj., elementë jugosllavë, që prej principeve të tyre politikë mund të sjellin dobi, t'u dërgohen edhe disa të holla.

AQSh, Fondi 251, viti 1937, dos.126, dok.6-11.

* * *

**Promemorie e MP Jashtme së gjysmës së dytë të vitit 1938
që instrukton stafin e vet diplomatik në Jugosllavi për politikën që
duhet ndjekur për të ndihmuar popullsinë shqiptare në Jugosllavi
dhe për të penguar shpërnguljen
e saj në Turqi**

PROMEMORIA

T'i vazhdojë Legata e Belgradit bisedimet me Zotin Stojadinoviç për të parë si e kupëton ay zgjerimin e formulës së ditur që pranuan maxharët dhe që drejtonjësit e Ministrisë së P. të Jashtëme i'a propozuan Zotit Tahir Shtyllës duke i thënë që ajo formulë mund të përdoret si bazë për t'a bërë të përshtatëshme me realitetin e relatave shqiptaro-jugosllave dhe me realitetin e minoriteteve shqiptare të Jugosllavisë. Cilado qoftë formula, ajo e maxharëve ose e zgjeruar, në nuk duhet t'a pranojmë po të jetë se do të redizhohet në formën e një komunikate zyrtare dhe të botohet vetëm në Agjencitë zyrtare të të dy vendeve, ashtu si do të bëhet me maxharët, me që kjo formulë nuk është angazhuese aspakë, dhe duhet të vëmë që të tre pikat që i kemi kërkuar, d.m.th. 1^o, mos dëbimi i shqiptarëve në Turqi, duke kërkuar që një shqiptar i Turqisë ose nga të minoriteteve shqipëtare të Jugosllavisë, të marrë pjesë në komisionin mikst turko-jugosllavë që do të dallojë shqiptarët nga turqit, 2^o, të mos ju merren më tokat shqipëtarëve të Kosovës që kështu të mundin këta të jetojnë në Jugosllavië dhe 3^o, të jetë Guvernë jugosllave më tolerante me shqipëtarët që këta të mësojnë e të kultivojnë gjuhën amtare. Angazhemanët e këtyre tre kërkesave t'ona Guverna jugosllave t'i marrë me

shkrim, në një formë që të dy palët t'a gjejnë t'arësishme, dhe Guverna jonë pranon dhe formën e një çkëmbim notash të cilat të mbahen të fshehura nga të dy palët dhe të botohet vetëm një komunikatë si ajo që u pranua të bëhet prej maxharëve. T'i thomi Guvernës jugosllave, si përgjigje të propozimit që ka bërë, që Guverna shqiptare do të pranonte të hynte në bisedim me Guvernën jugosllave, atëherë kur relatat e të dy Shteteve të viren me bazat e shënuara këtu më sipër, për të gjetur një lëmë kuptimi që, për t'hollat që Guverna jugosllave do të shpenzojë për të tharë pjesën shqipëtare të liqenit të Shkodrës, Guverna e jonë të pranojë në Shqipërië një sasi familjesh shqipëtare që banojnë në vise të holla e të brendëshme të Kosovës e të kufirit, si bije fjala, të Prishtinës, të rethit të Mitrovicës e të Gjilanit etj. Në qoftë se Zoti Stojadinoviç pranon këto kërkesat t'ona dhe mer angazheme me shkrim se do t'i respektojë, atëherë Guverna shqiptare është gadi të nënshkruajë një pakt miqësie ose mos-agresioni, si dhe të marrë angazheme; doemos në bazë reciprociteti, që nuk do të tolerojë në tokën e saja asndonjë vepër drejtuar kundër Jugosllavisë. Kjo është një nga kërkesat e Zotit Stojadinoviç.

Të kultivojmë me çdo mjet miqësinë nërmjet myslimanëve bosnjakë dhe myslimanëve shqipëtarë, duke përdorur këtu vetëm ndjenjën fetare që nër bosnjakët është tepër e fortë dhe të bëjmë që shqipëtarët e Kosovës të jenë nënë influencën e politikës të brendëshme të Zotit Mehmet Spaho. Ky ka interesa vitale që të qëndrojnë të gjithë myslimanët në Jugosllavië sepse duke pasur këta, një bllok afro 1.500 mijë frymë, ay peshon në balancën e politikës së brendëshme. Sa të pakësohen këta, aqë i pakësohet dhe atij influenca e tij politike. M'anë tjetër vëllaj i tij, si dihet, është Reisylylema i të tërë myslimanëve të Jugosllavisë, pra ka çdo interesë dhe arësye që të bashkohet me né në fushatën për të ndaluar emigracionin në Turqi të shqipëtarëve myslimanë. Si u tha, duhet bërë sa është e mundur që të forcohet miqësia që egziston dhe tani në një shkallë të gjerë nërmjet myslimanëve boshnjakë dhe myslimanëve shqipëtarë, dhe për këtë qëllim, titullari i Legatës së Belgradit t'i thotë Zotit Mehmet Spaho, si nga ana e tij, fjalët e urta dhe larg-shikonjëse të Naltmadhënisë së Tij Mbretit, duke bërë sondazhet që të mësojë opinionin e tij për sa i përket një dekorateje që do të dëshëronim t'i nepnim. Gjithashtu do të bëhet dhe me Ministrin tjetër boshnjak Zotin Xhafer Bey Kolenoviçin që i ngarkuar nga Stojadinoviçi, po i pregatit këtë një memorandum mbi grabitjet e tokave të shqipëtarëve dhe i cili është krahu i djathtë i Zotit Mehmet Spaho. Duke u inspiruar nga fjalët e Naltmadhënisë së Tij Mbretit të mundohemi t'a afrojmë Zotin Koroshec dhe të bëjmë sa është e mundur që të simpatizojë fushatën t'onë në gjinë e Guvernës së bashku me Mehmet Spahon. Si është bërë gjer tani, me anën e intelektualëve kosovarë, të

vëmë gjithënjë në kurent kryetarët e opozitës kroate mbi sa po përgatitet në kuriz të shqipëtarëve, t'u njoftoj padrejtësitë dhe keq përdorimet, duke ju transmetuar që t'i botojnë, si kemi bërë dhe herë tjetër, që të gjitha dokumentet që provojnë këto pa drejtësi.

3° Të mbledhim në Belgrade, dhe sa të jetë e mundur dhe në Shkup Ferhat Bejnë me shokët e tij, Deputetët, Senatorët, Parësinë Kosovës, fetarët Muhamedanë dhe që të gjithë bashkëpunëtorët t'anë, të cilëve t'u tregojmë situatën e vërtetë. T'u thomi përpjekjet e mbëdhaja të Naltmadhënisë së Tij Mbretit për t'i shpëtuar nga reziku që po u kërcënohet, sakrificat që Ay po bën dhe që është gadi të bëjë kurdoherë që nevoja t'a lypë, t'u theksojmë përpjekjet t'ona në lëmën ndërkombëtare duke interesuar për këtë çështje Fuqitë e Mbëdhaja dhe Guvernat mike të Shqipërisë, përpjekjet t'ona në Turqi për të ndaluar raktifikimin e konventës që u stipullua në Stambollë, bisedimet që kemi nisur në Guvernën e Belgradit që eventualisht të gjejmë një formulë marrëveshjeje në këtë Guvernë, marrëveshjeje që për ne do të ketë vetëm qëllimin që t'i shpëtojme nga emigracioni në Turqi dhe shpresën që atyre vëllezërve t'anë t'u përmirësohet rojtja në tokën jugosllave. Të gjitha këto të ja u thomi, pa ja u fshehur, por, opinionin t'onë që, ndonëse po bëjmë dhe do të bëjmë sa të jetë e mundur dhe e pa mundur, shpresat e mbëdhaja duhet t'i kemi në fuqitë t'ona dhe në patriotizmin e tyre. Ata duhet qysh tani t'i përvishen punës bashkë me ne duke vizituar katundet më të vogla e më të largta të Kosovës, duke këshilluar shqipëtarët që të mos largohen nga vatrat e tyre, që të mos deklarohet turq qoftë para autoriteteve locale, qoftë para komisionit mikst që do të ngarkohet për emigracionin e tyre në Turqi. T'u thomi që ne jemi gadi t'i ndihmojmë financiarisht për të përballur shpenzimet e lëvizjeve të tyre, dhe të kësaj propagande që do të bëjnë. T'u theksojmë edhe që, në qoftë se përpjekjet t'ona në Belgradë e në Stambollë, si dhe pranë Fuqive të Mbëdhaja dhe mikst të Shqipërisë do të dështojnë, dhe atëherë kur t'i presim shpresat që do të gjejmë një shpëtim në këtë lëmë, do të fillojmë një aksion në shkallë të gjerë këtu në Shqipërië me manifestacione rrugash, me interpellata në Parlament, me stakime në shtypin kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe duke i paraqitur Shoqërisë së Kombeve dhe Fuqive të Mbëdhaja që interesohen për mbajtjen e paqes, ankimet t'ona dhe duke u denoncuar tmerret e persekutimit jugosllavë kundër minoriteteve shqipëtare, dhe xhambasllëket që bëhen nërmjet Turqisë dhe Jugosllavisë në kurizin e tyre. T'u themi këtyre edhe që, kur t'a shohëm rezikun s'afërmi, atëherë

një sasi familjesh t'atyre që i shtrëngojnë të shkojnë në Turqi, t'i marim në Shqipërië dhe këtu t'i installojmë.

4^o Ferhat Bey Draga, simbas urdhërit të Naltmadhënisë së Tij Mbretit të vejë në Turqi dhe po të jetë që nuk e gjykon të rezikshëme për kthimin e tij në Jugosllavië, të kthehet këtu në Shqipërië për disa ditë. Në qoftë se këshillat e Naltmadhënisë së tij do t'a bindin që të modelojë qëndrimin e tij duke bashkëpunuar me shokët e tjerë dhe me methudat e tyre, athere të kthehet dhe ay në Jugosllavië dhe së bashku t'i përvishemi punës, dhe po t'a gjykojmë që këto këshilla nuk do të jenë efikase, athere pa i dhënë të kuptojë që ne, shokët e tij dhe Mehmetë Spahoja dëshërojmë largimin e tija për ca kohë gjer sa të kthjellohet situata, të këshillohet që të vejë në Vjenë për të kaluar disa kohë së bashku me familjen e tija. M'anë tjetër duhet ne dhe shqipëtarët e Kosovës që të punojmë që të ja ngrehim prestixhin e tij në Kosovë sepse në rastin e dështimit të përpjekjeve t'ona, personi i tij është më i dobishmi për të mbajtur lart kurajën e Kosovarëve dhe për t'a axhituar çështjen për të cilën u bë aqë herë fjalë.

AQSh, Fondi: MPJ, viti 1938, dos.107/2, dok.763-766.

* * *

Promemorie e dt. 20.03.1939 e MP Jashtme dërguar stafit të vet diplomatik në Jugosllavi mbi politikën e rekomanduar nga A. Zogu në mbështetje të popullsisë shqiptare në Jugosllavi

PROMEMORIA

Në lëmën politike, simbas urdhërit që u dënjua të na japë Naltëmadhënia e Tij Mbreti, Legata Mbretnore e Belgradit do të vazhdojë punën e saja të gjertanishme duke u munduar që t'i përmirësojë marrëdhënjet nërmjet të dy Shteteve dhe në Guvernën e Z. Svetkoviç, po n'atë mynyrë që bëri dhe me Guvernën e Z. Stojadinoviç. Të ruhet kjo atmosferë miqësore që u krijua gjat këtyre dy vjetëve të fundit, gjithënjë duke i theksuar Guvernës Jugosllave që nërmjet të të dy Shteteve nuk ka çështje tjetër që të na ndajë përveç se ajo e minoriteteve t'ona në Jugosllavië, kurse një grumullë interesa ballkanike dhe kufizore na lidhin në miqësi të ngushtë. Të përfitojmë nga dobësia e Guvernës te Svetkoviçit dhe nga fuqia e pa kufishme e Mehmet Spahos që t'i regullojmë në formën definitive dy pikat kryesore të politikës t'onë

minoritare: ndalimi i marjes së tokave, dhe ndalimi i emigracionit në Turqië. Për rregullimin definitiv të këtyre dy pikave kryesore kupëtohet bërja e një ligji që të ndalojë kryekëput grabitjen e tokave të shqipëtarëve, qoftë ato që janë të matura, qoftë ato që edhe nuk janë të matura dhe, për sa i përket emigracionit, të anulohet projekti i Konvencionit që kanë parafuar në Stambollë, turqërit dhe jugosllavët, në Prillë të vitit 1938, dhe në mos i'a arrifshin këtij qëllimi, të paktën të bëjmë që projekt Konvencioni në fjalë të përfshijë shumën e saktë të turqëve që banojnë në Jugosllavië, duke caktuar dhe një nga një vendet ku këta turqër banojnë. Një bashkëpunim i ngushtë të rivendoset nërmjet Përfaqësonjësve të minoriteteve t'ona dhe Kryetarit të Kroatëve Z. Maçek, gjithënjë duke ruajtur lidhjet që kemi me Mehmet Spahon.

Në lidhje me ngjarjet e fundit të Evropës Qendrale duhet punuar në mynyrë që të mësojmë me shigurië tendencat e Belgradit: të shohim me saktësië që në rast se Belgradi i ndruhet ekspansionit gjerman dhe në tokën jugosllave duke përfituar nga situata e turbulltë e brendëshme, a do t'anojë Jugosllavia për nga Italia a po jo, dhe në rast se i ndruhet një ndërhyrjeje t'Italisë në Ballkan a do t'anojë nga Gjermania. Mejtohet që qëndrimi i Jugosllavisë në rastin e këtyre dy eventualiteteve ka një rëndësië të dorës së parë për ne, sepse ky qëndrim i Belgradit do të na orientojë që të dimë si të qëndrojmë dhe ne, qoftë ndaj Jugosllavisë, dhe Shteteve të tjera të Ballkanit, qoftë ndaj Italisë.

Politika Minoritare

Simbas urdhërit që u denjua e na dhà Naltmadhënia e Tij Mbreti, për politikën t'onë minoritare do të krijohet një Komitet nënë kryesinë e Ferhat Dragës vepra e të cilit do të drejtohet nga Legata Mbretënore e Belgradit. Ky Komitet do të përbahej prej ma së pakti tre anëtarësh, të cilët mund të jenë këta: Deputetët Salih Kadri dhe Ilias Prishtina dhe Senatori Muhamet Sllatkoja ose Xhevat Begolli. Me pëlqimin e Naltmadhënisë së Tij nonjë nga këta persona mund të ndryshohet dhe t'emërohet një tjetër. Në lidhje me formimin e këtij Komiteti, shihet e domosdoshme ardhja e Ferhat Dragës në Shqipërië, sepse vetëm kështu Naltmadhënia e Tij do të ketë rast dhe të denjohet t'i napë udhëzime të caktuar që ky të bashkëpunojë me shokët e tjerë të Komitetit. Pa këto udhëzime na duket e pa mundur që të vendoset një bashkëpunim nërmjet anëtarëve dhe Kryetarit të Komitetit në fjalë, dhe i dyshimtë do të jetë rezultati i punës së kërkojmë nga ky Komitet.

Komiteti i formuar në mënyrën që u shënuar në pikën 3 të këtyre notave, nënë drejtimin e Legatës Mbretnore të Belgradit do të ketë për program që të zhvillojë një aktivitet për mbrojtjen e tokave të shqipëtarëve të Kosovës, të ndalojë emigracionin në Turqië, të drejtojë Komunitetin Muhamedan të Shkupit, të organizojë elementin fetar, muhamedan e të krishterë, duke përkrahur organet përkatës, t'organizojë propagandën e shqipëtarizmit në Kosovë, të drejtojë mësimet e brezit të ri dhe Institutet kulturele të krijuara për këtë qëllim dhe me një fjalë të veprojë në ç'do lamë të politikës t'onë minoritare në Kosovë.

Si fillim t'aktivitetit të këtij komitet do të kemi zbatimin e këtyre pikave:

a) Të themelojë një fletore në gjuhën sllavishte dhe turçe, më tutje e eventualisht dhe një faqe në gjuhën shqipe, që të jetë organ i komunitetit muhamedan për mbrojtjen e të drejtave minoritare të muhamedanëve shqipëtarë të Kosovës;

b) Të çelë 7 pensionate në të 7 N.Prefekturat e Kosovës ku ndodhet një Gjimnas Shteti: këto pensionate do të kenë 10 djelmosha të mbledhur në katundet e Kosovës, bij Bajraktarësh dhe Agallarësh, që t'i venë në gjindje të vazhdojnë mësimet e mesme në qendrën e N.Prefekturës dhe masandaj n'Universitetet e Jugosllavisë. Këto Pensionate do të figurojnë se mbahen me subvencionet e Organizatës së "Merhametit" dhe për mbajtjen e këtyre do të paraqitet buxheti i shumës që nevojitet. Natyrisht Pensionatet do të pajisen me libra shqipe që t'i kultivojnë djelmoshat shqipëtarë në gjuhën amtare;

c) Komiteti do të paraqitë një listë të fetarëve muhamedanë e katolikë të cilët do t'i ndihmojnë që t'i venë në gjindje të zhvillojnë aktivitetin e tyre në qendrat respektive;

d) Të përgatitë preventivin e librave shqipe që nevojiten për rritjen e brezit të ri kosovar në gjuhën amtare;

e) Të përkujdeset për çpërndarjen e revolverëve që Naltmadhënia e Tij do të denjohet t'u falin Bajraktarëve, Agallarëve dhe Parisë Kosovare përgjithësisht. Gjithashtu do të bëjë dhe për çpërndarjen e Orëve, prapë me Stemen e Mbretit, që Sovrani i ynë do të denjojë t'u falë Parisë të Kosovës;

f) Të përkujdeset për çpërndarjen e Radiove me anëne e Tregëtarëve që do t'i instalojmë, njërenë në Shkup dhe tjetrin në Belgradë;

g) Do të gjejnë dhe studentët e tjerë universitarë që t'a ngrehim në 50 numrin e tyre.

Tiranë më 20 të marsit 1939.

AQSh, Fondi: MPJ, viti 1938, dos.107/2, dok.796797.